



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20-26/2018 regjistër (JR)
Datë 13.02.2023

Nr. 60 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ditën e martë, më datë 24.03.2026, në orën 11:20, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen që i përket:

KËRKUES: Elsion Sadiku, i datëlindjes {***}, me adresë, Rr. “{***}”, Nd. {***}, H. {***}, Ap. {***}, Korçë, me nr. tel: {***} dhe adresë elektronike {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet dhe parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili në përfundim kërkoi rishikimin e vendimit nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ElSION Sadiku (në vijim “kërkuesi”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Pas zhvillimit të hetimit administrativ, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 50, datë 27.07.2018, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. ElSION Sadiku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*”.
3. Kërkuesi ElSION Sadiku, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit kundërshtoi vendimin nr. 50, datë 27.07.2018 të Komisionit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, (në vijim “Kolegji”), i cili me vendimin (JR) nr. 7, datë 05.04.2019, vendosi: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 50, datë 27.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit ElSION Sadiku.*”.
4. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegji kërkesat për rishikimin e vendimit të sipërcituar të Kolegjit, si vijon:
 - (i) Kërkesën e regjistruar si çështja me nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023;
 - (ii) Kërkesën e regjistruar si çështja me nr. 47-26/2018¹ (JR), datë 18.04.2023;
 - (iii) Kërkesa nr. 1241 prot., datë 11.12.2024.

II. Pretendimet e kërkuesit

5. Kërkuesi, në kërkesën e regjistruar në Kolegji si çështja me nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023, ka parashtruar se është vënë në dijeni të faktit se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në datën 04.10.2022, ka dhënë vendimin nr. 37474/20 që i përket çështjes “*Besnik Cani kundër Shqipërisë*”, botuar në fletoren zyrtare nr. 14, datë 25.01.2023. Sipas kërkuesit, me vendimin e sipërcituar, kjo Gjykatë ka vendosur në mënyrë unanime se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me parimin e “gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj”, për shkak se anëtari i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit z. L. D., është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në shkelje flagrante të kritereve ligjore për të qenë anëtar i Kolegjit.
Kërkuesi duke iu referuar përcaktimeve të Kushtetutës dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese², ka parashtruar se e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare ka një vend të posaçëm në sistemin e burimeve normative dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut gëzon një status akoma më të privilegjuar.

¹ Me shortin e datës 17.02.2024, kjo kërkesë i ka kaluar për shqyrtim trupit gjykues të shortuar për gjykimin e çështjes me nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023, që i përket kërkesës së parë të z. Sadiku.

² Vendimi nr. 6/2006, vendimi nr.9/2010, vendimi nr.20/2011 të Gjykatës Kushtetuese.

5.1. Kërkuesi referon në shkronjën “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile për rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019 të dhënë nga Kolegji ndaj tij, dispozitë e cila parashikon se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: “ë) *Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*”. Kërkuesi ka argumentuar se kërkesa e tij për rishikim është dorëzuar brenda afatit 30-ditor të marrjes dijeni për shkakun e rishikimit, parashikuar në nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe brenda afatit 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ka kërkuar përfundimisht: (i) pranimin e kërkesës; (ii) rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

6. Kërkesën e regjistruar në Kolegji si çështja me nr. 47-26/2018 (JR), datë 18.04.2023, kërkuesi e ka mbështetur në shkronjën “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar se gjendet përballë një rrethane të re, që lidhet me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. akti {***}, datë 21.02.2023, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe ky i fundit ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me këtë vendim, gjyqtari L. D. është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Ndodhur në këto kushte, sipas kërkuesit, prania e ish-gjyqtarit në trupin gjykues që ka shqyrtuar vendimin e dhënë nga Komisioni ndaj tij, në fshehje të faktit se ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar në vitin 1997, pra në shkelje flagrante të kriterëve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Për rrjedhojë, duke qenë se vendimi i sipërcituar i gjykatës ka marrë formë të prerë, bazuar në nenin 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, kërkuesi ka pretenduar se ka interes të ligjshëm që nëpërmjet mjetit të jashtëzakonshëm të ankimit të kërkojë rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit.

6.1. Gjithashtu, në vijim të shtjellimit të argumenteve, kërkuesi citon qëndrimin e GjEDNJ-së, në çështjen “*Sevdari kundër Shqipërisë*”, sipas të cilit mjeti efektiv për të rregulluar pasojat nga pjesëmarrja e z. L. D. në cilësinë e gjyqtarit në proceset e rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është rihapja e këtyre proceseve. Po ashtu, kërkuesi referon çështjen “*Besnik Cani kundër Shqipërisë*”, me argumentin se në këtë vendim GjEDNJ-ja ka njohur mundësinë për rishikimin e vendimeve, pasi ka konkluduar për shkelje të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Po ashtu, kërkuesi ka parashtruar se GjEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se prezenca e një anëtari të trupës gjykuese të dënuar me vendim penal të formës së prerë (z. L. D.), përbën shkak për cenim të procesit të rregullt ligjor. Kërkuesi ka pretenduar se prania e gjyqtarit L. D. në trupin gjykues që shqyrtoi çështjen e tij në Kolegji, përbën shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së, pasi ka kryer një veprë të dënueshme penalisht dhe ka ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e tij të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në kuadër të përcaktimeve të nenit 494, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile,

kërkuesi ka kërkuar rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019, të dhënë nga Kolegji ndaj tij.

7. Kërkesën e regjistruar në Kolegj me nr. 1241 prot., datë 11.12.2024, kërkuesi e ka mbështetur në shkronjën “c” të nenit 494, të Kodit të Procedurës Civile, duke pretenduar se gjendet përballë një rrethane të re, që lidhet me vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me anë të të cilit gjyqtari A. H., anëtar i trupit gjykues të Kolegjit që shqyrtoi vendimin e dhënë ndaj tij nga Komisioni, është dënuar me vendim të formës së prerë³ për veprat penale “Fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Sipas pretendimit të kërkuesit, pavarësisht se ky anëtar nuk ishte i dënuar në kohën e emërimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nëse veprimet e kundërligjshme të tij do të zbuloheshin në kohën e emërimit ose gjatë ushtrimit të mandatit, ai nuk do të plotësonte kriteret për të qenë gjyqtar ose mandati i tij do të ishte ndërprerë. Ndodhur në këto kushte, prania e gjyqtarit në trupin gjykues që ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të dhënë nga Komisioni për procesin e tij të rivlerësimit, përbën jo vetëm papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit por veçanërisht, cenim të procesit të rregullt ligjor dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, vendimi i dhënë nga Kolegji duhet të korrigjohet, minimalisht duke i dhënë të drejtë kërkuesit të dëgjohet publikisht nga një trup gjykues i pavarur, i paanshëm dhe me integritet. Sipas kërkuesit, pjesëmarrja e z. A. H. si anëtar i trupit gjykues në Kolegjin e Posaçëm të Apelit në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në Kushtetutë dhe ligjin nr. 84/2016, duke kryer njëkohësisht edhe një vepër penale, e konfirmuar me vendim të gjykatës penale të formës së prerë, krijon një situatë e cila konsiderohet si shkelje e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me parimin e “gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj”.

Kërkuesi ka kërkuar, përfundimisht: (i) pranimin e kërkesës; (ii) rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

a) Bashkimi i kërkesave

8. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm të datës 24.03.2026, bazuar në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, në nenin 448 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 19, pika 1/1 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, vendosi të bashkojë për gjykim çështjen nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023 me çështjen nr. 47-26/2018 (JR), datë 18.04.2023, si dhe kërkesën nr.

³ Me vendimin nr. 47 (87-2024-330), datë 18.11.2024, të Gjykatës së Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

1241 prot., datë 11.12.2024, të kërkuarit Elision Sadiku, si kërkesa që kanë të njëjtin objekt: rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

b) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. Në vijim të sa më sipër, i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
10. Kolegji, në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që u përket kërkesave për rishikim të kërkuarit Artor Ylli⁴, ka arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej ka arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuarit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjyqësor i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohet ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuari. Sa më sipër, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, sipas të cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.
11. Në vendimin e cituar në paragrafin më sipër, është marrë në analizë nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me

⁴Shih vendimin e Kolegjit nr. 12, datë 29.04.2024, në https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf.

qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuara organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimin e referuar më sipër, por edhe në vendimet e marra më pas që kanë shqyrtuar kërkesa të ngjashme për rishikimin e vendimeve të Kolegjit⁵, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

12. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, shkronja “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës. Parashikimi i nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të konventës dhe protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.
13. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në shkronjën “ë”, parashikohet se: *“Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: “ë) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”*. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, po ashtu edhe gjykatat me juridiksion specifik, siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jovendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germat e para të nenit 494 të Kodit të

⁵ *Vendimet e Kolegjit, me objekt shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi: Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.02.2025; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025; vendimi nr. 18, datë 08.05.2025; vendimi nr. 19, datë 08.05.2025.*

Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

14. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga kërkuesi, pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht nga Kolegji në trajtimin e kërkesave me të njëjtën natyrë e objekt, si dhe duke ndjekur të njëjtën analizë sistematike të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, dhe sipas orientimeve të instrumenteve ndërkombëtare, që normojnë parimet mbi të cilat zhvillohet edhe procesi i rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues rikonfirmon vlerësimin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit dhe në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, si dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
15. Në kushtet kur për kërkuesin nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja të ketë konkluduar për shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit kalimtar të kryer për të, trupi gjykues vlerëson se kërkesat për rishikim e vendimit nr. 7 (JR), datë 05.04.2019 të Kolegjit nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas pikës 8, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile.
16. Së fundmi, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, trupi gjykues çmon se ato sërish, të vlerësuara në një analizë *obiter dictum*, edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, do të konsideroheshin të pabazuara në fakte dhe në ligj. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve për cenim të parimit të “gjykatës së krijuar me ligj”, për shkak të parregullsive në emërimin e z. L. D. si gjyqtar i Kolegjit, trupi gjykues sjell në vëmendje se GjEDNj-ja, në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë* ka mbajtur qëndrimin se: “144. [...] *konstatimi i një shkeljeje në të drejtën për një gjykatë të krijuar me ligj në çështjen konkrete, në vetvete, mund të mos merret si shkak për të ushtruar një detyrim sipas Konventës ndaj Shtetit përgjegjës për të rihapur të gjitha çështjet e ngjashme të cilat janë bërë res judicata sipas ligjit vendës (Shih çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson*)*”. Sipas këtij qëndrimi të GjEDNj-së, nuk mund të shqyrtohet *a priori* çdo kërkesë për rishikimin e vendimeve të dhëna nga trupat gjykuese të Kolegjit ku ka qenë anëtar ish-gjyqtari L. D., vetëm për shkak të parregullsive në emërimin e tij dhe u takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “*të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme, të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues, që justifikon shmangien*” nga

parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështje”⁶.

17. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit në lidhje me veprat penale të kryera nga gjyqtarët L. D. dhe A. H., trupi gjykues vëren se edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, këto pretendime do të konsideroheshin të pabazuara në fakte dhe në ligj, pasi mungon lidhja shkakësore mes vendimmarrjes së anëtarëve të trupit gjykues (L. D. dhe A. H.) në çështjen e rivlerësimit të kërkuarit dhe veprës penale për të cilën z. D. është deklaruar fajtor, apo për veprën penale që pretendohet të jetë kryer nga z. H.. Parashikimet ligjore që lidhen me rishikimin, në asnjë rast, nuk u referohen ndodhive, fakteve apo rrethanave, të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë ose janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi. Pala kërkuar duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të kundërshtuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari ka marrë vendimin, vullneti i tij është vesuar për shkak të një vepre penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari në shkelje të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit, provuar nga një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime, është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, shtjelluar në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë diktuar nga parashikimi i nenit 6/1 të Konventës. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Brumarescu kundër Rumanisë*, sipas të cilit cenimi i një vendimi gjyqësor përfundimtar mund të legjitimohet vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”⁷.
18. Në rastin konkret, fakti se vepra penale është kryer nga z. D., si dhe ajo e pretenduar se është kryer nga z. H., ka ndodhur para se ata të zgjidheshin në funksionin e gjyqtarit të Kolegjit dhe nuk lidhen me procesin e zgjedhjes së tyre në këtë detyrë, shkaput çdo lidhje logjike dhe shkakësore midis dhënies së vendimit për të cilin kërkohet rishikimi dhe veprës penale. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk gjen zbatim neni 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, sikurse është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera⁸.

⁶ Referuar paragrafit 88 të vendimit të cituar të GjEDNj-së: “Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata theksoi se parimi i shtetit të së drejtës përfshin një numër parimesh të tjera po aq të rëndësishme dhe mundësisht kundërbalacuese. Këto parime përfshijnë veçanërisht sigurinë ligjore dhe respektin për forcën e res judicata, si edhe parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre; shmangia nga këto parime mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të mirëpërcaktuara. U takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyruar – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështjeje”.

⁷ Shih “*Brumarescu kundër Rumanisë*”, “*Pravednaya kundër Rusisë*” prg. 25, “*Bratyakin kundër Rusisë*”, ndër të tjera.

⁸ Shih për referencë vendimin që i përket kërkesës së znj. R. G.:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.oxc-1.pdf, si dhe vendimin që i përket kërkesës së znj. A. G.:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2024/11/Vendimi_Ana_Golloshi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar-1-rishikim.pdf.

19. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesat për rishikim të paraqitura prej z. Elsion Sadiku, janë të pabazuara në fakte dhe në ligj dhe për pasojë ato konsiderohen të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenet 494 dhe 498 pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

V ENDOSI:

Mospranimin e kërkesave të kërkuesit Elsion Sadiku, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 7, datë 05.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me: (i) nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023; (ii) nr. 1241 prot., datë 11.12.2024; (iii) nr. 47-26/2018 (JR), datë 18.04.2023.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Mimoza TASI

nënshkrimi – kundër

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr.60 datë 24.03.2026, për çështjen nr. 20-26/2018 regjistër (JR) datë 13.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Elision Sadiku, për rishikimin e vendimit nr. 7 (JR), datë 05.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislati në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.⁹
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z.Elision Sadiku, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 16-18 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁹ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam dakord me vendimin nr. 60 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Alison Sadiku, për rishikimin e vendimit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me: (i) nr. 20-26/2018 (JR), datë 13.02.2023; (ii) nr. 1241 prot., datë 11.12.2024, (iii) nr. 47-26/2018 (JR), datë 18.04.2023”*, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuarja.
2. Në cilësinë e gjyqtare me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarës, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”*.
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”*.
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimeve të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e kryesueses, jam kundër shumicës së trupit gjykues në vendimin nr. 60, datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Elson Sadiku, për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 7 (JR), datë 05.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues¹⁰ të Kolegjit, për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ), sipas shkronjës “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494¹¹, shkronja “c”¹² të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente ndër të tjera në mendimin e pakicës ndaj kërkesës së kërkuarit R. T.¹³ si dhe mendimet paralele dhe qëndrimin e mbajtur prej meje në kërkesat për rishikim të paraqitura në çështje të tjera¹⁴.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNJ-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNJ.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNJ-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të

¹⁰ Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupit gjykues në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues.

¹¹ Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] (c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; [...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

¹² Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

¹³ Vendimi nr. 19, datë 08.05.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit R. T., për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 26 (JR), datë 21.10.2019.

¹⁴ Vendimi nr. 9, datë 28.2.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 11 (JR), datë 03.07.2020; Vendimi nr. 18, datë 8.5.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 9 (JR), datë 26.6.2020 etj.

5.4. Për sa më lart, shkronja “c”, e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile duhet të zbatohet nga Kolegji i Apelit, ashtu si është shkruar, çka nënkupton se kjo dispozitë nuk ka parashikuar raste përjashtimore për kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues. Pra, neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rregullime shumë të detajuara dhe në mënyrë shteruese për rastet e kërkesave për rishikim. Ligjvënuesi, duke i kushtuar një rëndësi e kujdes të posaçëm rregullimit në Kod të institutit të rishikimit të vendimit (si në rastin e shkronjës “c”), nuk mund të linte pa rregullim të specifikuar ndonjë përjashtim nga parashikimi i përgjithshëm i shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos e lënë të nënkuptohet nga zbatuesit e këtij Kodi as kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues dhe as ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore për ndikim në dhënien e vendimit nga trupa gjyqësore.

5.5. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së dhe lexuar në harmoni me përmbajtjen e nenit 494/c të Kodit të Procedurës Civile, ekziston një detyrim që vendimet e marra nga një trup gjykues që nuk plotëson kërkesat e një gjykate “të krijuar me ligj”, duhet të rishikohen, për të siguruar që çdo padrejtësi e mundshme të korrigjohet. Ky pohim përbën një masë të nevojshme dhe merr një peshë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri, ku integriteti i procesit të *vetting*-ut, si një proces i jashtëzakonshëm e kalimtar, është thelbësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi, edhe integriteti i trupit gjykues është thelbësor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Çdo shkelje e këtij integriteti si, dënimi penal i një gjyqtari, duhet trajtuar me seriozitet për të ruajtur besueshmërinë e procesit gjyqësor.

5.6. Kolegji i Posaçëm i Apelit, si organi kushtetues më i lartë dhe e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, si institucioni i pavarur që Kushtetuta²⁰ i ka dhënë atributet e Gjykatës Kushtetuese²¹ dhe i ka përcaktuar një mision të qartë, si dhe që vendimmarrjet e tij t’i bazojë në parimet e procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, sipas parashikimeve të Konventës, Kushtetutës, ligjit të posaçëm²² dhe ligjeve të aplikueshme, duhet të demonstrojë dhe të transmetojë siguri juridike dhe qartësi për ato aspekte të gjykimit që dhënia e drejtësisë i sjell për të zbatuar, sikurse është edhe mjeti i jashtëzakonshëm i rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

5.7. Dënimi penal i një anëtari të trupit gjykues, për arsye që nuk lidhen me vendimmarrjen e tij, por me kushtet për të qenë anëtar i këtij Kolegji, cenon standardin e integritetit gjyqësor dhe besueshmërinë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, pozitën vendimmarrëse të Kolegjit të

²⁰ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

²¹ Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës parashikon se: “[...] Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”.

²² Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

Posaçëm të Apelimit, paanshmërinë e tij, si dhe standardin e gjykatës së krijuar me ligj, të parashikuar dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në fund të fundit, vendimi penal i formës së prerë ndaj një anëtari të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin e kërkuarit (në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit²³, është një fakt i pakundërshtueshëm, i cili në një formë apo në një tjetër implikon sjelljen institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, integriteti institucional i të cilit duhet të mbrohet nëpërmjet zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, që e kanë sanksionuar atë.

6. Lidhur me kërkesën e paraqitur në Kolegj më datë 11.12.2024, të cilën kërkuarisi sërish e bazon në nenin 494, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se: (i) shkak për rishikim, sipas pretendimit të kërkuarit përbën vendimi gjyqësor i shpallur më datë 18.11.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***}, që ka dënuar me vendim të formës së prerë²⁴ gjyqtarin A. H.; (ii) dënimi i z. H. dhe qenia e tij në cilësinë e kryesuesit në trupin gjykues që ka shqyrtuar vendimin e dhënë nga Komisioni cenon besimin e publikut te drejtësia; (iii) pjesmarrja e z. H. në trupin gjykues të Kolegjit ka qenë në kundërshtim me kriteret ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe konsiderohet shkelje e nenit 6 të Konventës lidhur me parimin e gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj; (iv) kërkesa paraqitet brenda afatit 30-ditor nga marrja dijani (11.12.2024); (v) kërkuarisi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar në Kolegj.
7. Sa i përket kësaj kërkesë, vlerësoj se kërkuarisi i është referuar vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili edhe pse është një vendim i formës së prerë, nuk përbën një vendim përfundimtar, në kuptim të *res judicata*. Nga burime të hapura, rezulton që ky vendim të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila ende nuk ka mbajtur një qëndrim për rekursin.
8. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, në trajtimin e çështjes së referuar, i kanë bërë një interpretim të qartë e të plotë kuptimit që duhet të ketë termi “vendimi i formës së prerë”, për efekt të gjësë së gjykuar, duke plotësuar mungesën e një përkufizimi juridik të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me shprehjen “*vendim i formës së prerë*” dhe se si duhet të konsiderohen nocionet “*vendim i ekzekutueshëm*”, “*vendim i formës së prerë*” dhe “*gjë e gjykuar*”. Kështu, në paragrafin 26 të vendimit, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se: “26. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet rikonfirmuar pohimi sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar [...]”.
9. Referuar vendimmarrjes unifikuese që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sa kohë që ndaj rekursit të gjyqtarit A. H., deri në momentin e gjykimit të kësaj kërkesë, nuk ka ende një

²³ Vendimi nr. 50, datë 27.07.2018, i KPK-së për subjektin e rivlerësimit Elision Sadiku.

²⁴ Gjyqtari A. H. është dënuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar nga nenet 180 dhe 257/a të Kodit Penal.

vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që të ketë shteruar rekursin, si mjet të zakonshëm ankimi, për pasojë, dënimi penal nuk ka marrë formë të prerë në kuptim të “gjësë së gjykuar”.

10. Në këto kushte, kërkesa e tretë e paraqitur nga kërkuesi, e bazuar në një vendim të Apelit, që nuk ka marrë formë të prerë, në kuptim të “gjësë së gjykuar”, në koherencë me qëndrimet e mia të mëparshme²⁵, vlerësoj se nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë nga ana formale, sipas parashikimeve të nenit 495 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

²⁵ Vendimi nr. 51, datë 11.3.2026, i kërkuesit A. Y.,